



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 17

Tiranë – E hënë, 30 maj 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. (11-2016- 2135) 738, datë 9.5.2016	Me objekt vazhdimin e procedurës së falimentimit	3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 21, datë 26.5.2016	Kërkesë për shprehje interesi, për shërbimin e konsulencës “e-Health Coordinator”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë	5



VENDIM

Nr. (11-2016-2135) 738, datë 9.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e përbërë prej:

kryetar i seancës gjyqësore: **Petraç Çuri**,
asistuar prej sekretares Eriola Gashi, sot në datën 9.5.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen civile që i përket:

KËRKUES: 1. Shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. me nr. NUIS J92406502S, me seli në Durrës, l. 17, pranë Tregut Industrial, me administrator Andi Koça e Artan Ziu, përfaqësuar me deklarinimin dhe me autorizimin, datë 29.12.2014, nga av. Ervin Demko, me nr. lic. 4868 dhe NUIS L31310501V, të Dhomës së Avokatisë Durrës.

2. Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë Tiranë, përfaqësuar me autorizimin nr. 42, datë 15.9.2014, nga Alfred Pupli, në mungesë.

PERSONA TË TRETË: 1. Qendra Kombëtare e Regjistrimit Tiranë, në mungesë.

2. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në mungesë.

3. Enkelejda Ziu, e bija e Miços dhe e Haretisë, e datëlindjes 13.9.1973, lindur dhe banuese në Durrës, l. 1, rr. “Taulantia”, nr. 1008, në mungesë.

4. Drejtoria e Tatim-Taksave, Bashkia Durrës, në mungesë.

5. Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Durrës, në mungesë.

6. Banka Kombëtare e Greqisë, përfaqësuar nga Ermira Lahi dhe Oligerta Kasneci.

7. Raiffeissen Bank, përfaqësuar nga Edison Arizaj dhe Arbër Ademi, me autorizimin, datë 24.4.2014, në mungesë.

8. ProCredit Bank, në mungesë.

9. OSHEE sh.a. Durrës, përfaqësuar nga Dorian Neziraj, me autorizimin nr. 110/3 prot., datë 6.10.2015, në mungesë.

10. Kompania celulare “Vodafone sh.a.”, përfaqësuar me autorizimin datë 22.7.2014, nga Klajd Shalësi, në mungesë.

OBJEKTI: Vazhdimi i procedurës së falimentimit.

Baza ligjore: neni 334 e vijues i KPC-së, nenet 7, 233 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata, pasi administroi provat dëgjoi palën kërkuese, që i kërkoi të vazhdojë procedurën e falimentimit.

Personin e tretë: NBG Bank, kërkoi mbylljen e procedurës së falimentimit.

Personat e tjerë të tretë: në mungesë.

Administratorja Falimentimit Shpresa Breçani, në mungesë;

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin datë 16.6.2017, ka vendosur:

Të pranojë kërkesën e kërkuesit shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

Hapjen e procedurës së falimentimit për palën kërkuese, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. me seli në Durrës, l. 17, pranë Tregut Industrial, me objekt veprimtarie: Tregtia me pakicë e mobilieve dhe e aparateve të ndriçimit.

Të caktojë si administrator të falimentit Robert Begaj, lindur në Vlorë e banues në Tiranë, rr. “Medar Shtylla”, 48/1.

“Hapja e procedurës së falimentimit u krye në orën 14: 30, të datës 16.6.2014.

Pala kërkuese, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., si dhe kreditorët, palët e treta Banka Kombëtare e Greqisë, Raiffeissen Bank, ProCredit Bank, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, Drejtoria e Tatim-Taksave, pranë Bashkisë Durrës, CEZ Shpërndarja, kompania Vodafon sh.a., duhet të paraqesin tek administratori i falimentit, pretendimet e tyre me shkrim, si dhe bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Afati i paraqitjes së pretendimeve nga palët kreditore nuk mund të jetë jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë nga data e këtij vendimi.

Kreditorët e palës kërkuese duhet të zhvillojnë mbledhjen për raportim, në datën 11 shtator 2014 ora 10:00. Nga ana e administratorit të Falimentimit duhet të paraqitet një raport para kësaj mbledhjeje dhe t’u komunikohet palëve kreditore.

Pala kërkuese debitore, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., duhet që detyrimet e saj t’ia paguajë administratorit të falimentit.

Urdhërohet QKR Tiranë të publikojë këtë vendim në internet, në faqen zyrtare të saj.

Një kopje e këtij vendimi t’u dërgohet personave të tretë që janë në mungesë dhe janë kreditorë të palës kërkuese.

Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet ZQRPP-së Tiranë, të gjitha bankave të nivelit të dytë, Drejtorisë së



Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, Autoritetit Rrugor Kombëtar Tiranë.

Heqjen e masës së sigurisë mbi pasuritë e palës kërkuese vendosur me vendimin e datës 21.5.2014.”

Gjykata konstaton se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për gjykimin e saj, është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi, se:

Pala kërkuese, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., është shoqëri e së drejtës tregtare shqiptare e regjistruar pranë QKR Tiranë, në datën 18.9.1999 dhe me aktivitet të saj, tregti me pakicë e mobilieve dhe e aparateve të ndriçimit.

Administratorë të saj janë dy ortakët, Andi Koça e Artan Ziu nga data 17.5.2011 deri në datën 17.5.2016.

Mbas vendimit të datës 16.6.2014, gjykata ka vazhduar procedurën e falimentimit dhe në datën 17.3.2016 nga ana e administratores së Falimentimit Shpresa Breçani është paraqitur “Raport mbi ecurinë e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.”, detyrë kjo e caktuar nga gjykata me vendimin e ndërmjetshëm të datës 22.2.2016.

Me vendimin nr. 45, datë 12.4.2016, kjo gjykatë ka vendosur:

“1. Të mos pranojë kërkesën e kërkueses shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k., të datës 22.2.2016, për ndryshim në planin e organizimit.

2. Të pranojë kërkesën e NBG Bank të datës 22.2.2016.

Nxjerrjen jashtë procedurës së falimentimit të pasurive të lëna kolateral, me:

1. Kontratë hipotekimi nr. 879/1, me nr. 595 rep. dhe nr. 309/2 kol., datë 26.5.2010, hipotekues janë Andi Koça Artan e Enkelejda Ziu.

Pasuritë:

Apartament 151 m², nr. pas. 26/160+1-21, ZK 8512;

Apartament 151 m², nr. pas. 26/160+1-22, ZK 8512;

Ndërtesë 3-katëshe, banesë dhe dyqane nr. pas. 9/206 ZK 8513, Durrës.

3. Të mos pranojë “Raportin mbi ecurinë e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.”, të datës 17.3.2016, të administratores së Falimentimit Shpresa Breçani.

4. Të pranojë kërkesën e administratores së Falimentimit për pagesën e saj në masën 1.500.000 lekë, e cila do të paguhet nga pala kërkuese shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.”

Mbas dhënies së këtij vendimi, gjykata caktoi seancën e sotme, për të vendosur lidhur me vazhdimin ose jo të kësaj procedure falimenti.

Nga ana e administratores së Falimentimit Shpresa Breçani, u paraqit kërkesa e datës 12.4.2016, sipas së cilës ajo kërkon që shpenzimet e saj si administratore, në mënyrë që ajo të ekzekutohet vullnetarisht.

Gjykata vlerëson se në kushtet kur pala kërkuese nuk ka ekzekutuar vendimin e gjykatës, për mungesë të fondeve financiare, administratorja mund ta vërë në ekzekutim pranë një zyre përmbarimore për ekzekutimin e këtij vendimi.

Gjykata konstaton se procedura e falimentimit e palës kërkuese bazohet në nenet 13 dhe 14, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje pala kërkuese ndryshoi aktivitetin e saj tregtar, duke u regjistruar si “Shkolla e mesme jo-publike “Tenta” sh.p.k.”, në datën 15.6.2015, me administratore personin e tretë të thirrur në këtë gjykim, Enkelejda Ziu, bashkëshortja e ortakut Artan Ziu.

Administratorja e Falimentimit Shpresa Breçani, në “Raportin mbi ecurinë e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.” në pikën “1/a” të saj, shprehet:

“a) debitori ka dështuar në paraqitjen e një plani organizimi i cili mund të kishte mundësi të pranohej nga ana e kreditorëve.”

Në rrethanat kur nga ana e gjykatës, pasuritë kolateral të palës kërkuese “Mobil Eni” sh.p.k. janë veçuar nga masa e falimentimit, duke dalë jashtë kësaj procedure, gjykata vlerëson se kërkesa e kësaj shoqërie në cilësinë e debitorit, nuk mund të vazhdojë më të shqyrtohet nga kjo gjykatë, duke u vendosur mbyllja e procedurës së falimentimit, mbasi pala kërkuese nuk ka më mundësi financiare për shlyerjen e detyrimeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, pasi iu referua dhe neneve 2, 3, 7, 10, 19, 33, 34, 35 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 25.3.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”,



VENDOSI:

1. Të mbyllë procedurën e falimentimit të kërkueses, shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k., hapur me vendimin e datës 16.6.2014 të kësaj gjykate.

Një kopje vendimi t’i dërgohet për botim Fletores Zyrtare.

Kundër vendimit lejohet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës. Për palët në mungesë, ky afat fillon nga dita e nesërme e ditës së komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Durrës, në datën 9.5.2016.

GJYQTARI
Petraq Çuri

**REQUEST FOR EXPRESSIONS OF
INTEREST (REOI)
(CONSULTING SERVICES)**

May 26, 2016

ALBANIA

**ALBANIA HEALTH SYSTEM IMPROVEMENT
PROJECT (HSIP)**

LOAN NO: 8466 AL.

PROJECT ID NUMBER: P144688

Assignment Title: “e-Health Coordinator”

Reference No. HSIP/CS/IC/05-2015

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Health System Improvement Project (HSIP), and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The consulting services (“the Services”) include hiring of a local individual consultant for the position of **“e-health Coordinator”**.

The e-Health Coordinator will be responsible for coordination and monitoring of e-health related project activities, progress reporting and provision of technical assistance to the MoH divisions and other organizations involved in related activities.

The e-Health Coordinator will be responsible for:

- Timely implementation of e-Health related component activities;

- Ongoing monitoring of execution of project implementation plan, procurement plan and contracts;

- Timely submission of monitoring reports, according to project documentation and project operation manual, in accordance with the legislation of the Republic of Albania and the World Bank, and other reports upon requests;

- Preparation of materials required for project supervision by the World Bank’s project team and audit by external auditors;

- Ensuring confidentiality and non-disclosure of official and commercial secrets.

The e-Health Coordinator will be hired from the Ministry of Health of Albania, though a selection process, under a part time basis. He/she will report directly to the Deputy Minister of Health, who will be his/her, contract coordinator, to the Project Manager and / or to the World Bank as per the request. He/she will work in close collaboration with IT Department of Ministry of Health, other project beneficiaries and World Bank team, during the course of the project implementation.

The e-Health Coordinator should have:

- The Master Degree in information systems, informatics, computer science, electronics, electrical engineering, natural sciences or other relevant field;

- Minimum 5, preferably 10 years of professional experience in the field, including experience with government systems;

- Proven previous experiences in designing and developing IT systems in Public and Private Sector;

- Previous experience in health and/or health insurance computerization would be an advantage;

- Experience in similar assignments especially with public administration will be an asset;

- Experience of participation and working with in multidisciplinary teams;

- Previous Experience working with international agencies projects, preferably World Bank funded project;

- Previous experience working with foreign donors will be an advantage;



- Fluency in both written and spoken English;
The Ministry of Health, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible individual local consultants (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The short listing criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	General Qualifications	30 points
2.	Relevant Experience in the field of the assignment	50 points
3.	Capability to carry out the assignment	20 points
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank’s [Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers](#) (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank’s policy on conflict of interest.

The assignment will be performed by an **Individual Local Consultant**. The selection method to be applied is **Individual Consultant (IC)**, in accordance with the procedures set out the World Bank’s *Guidelines Selection and Employment of Consultants Under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers* (January 2011, revised July 2014).

Consultant shall perform the Services during the period commencing July 2016 and continuing through July 2021 *or* any other period as may be subsequently agreed by the parties in writing, under a time base contract. Level of input should be at least 10 days per month.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by **June 10, 2016**.

MINISTRY OF HEALTH (MOH)
Project Coordination Unit (PCU)
Health System Improvement Project (HSIP)

Tirana, Albania

Att: Blerina Dudushi

e-mail: hsip.dudushi@gmail.com

Att: Elma Dogani

e-mail: hsip.dogani@gmail.com

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016